

Demush Shala

## ARNAUT OSMANI NË EPOSIN HEROIK SHQIPTAR DHE NË ATË MYSLIMAN BOSANOHERCEGOVINAS

Eposi heroik shqiptar dhe ai mysliman bosanohercegovinas, duke trajtuar një pasuri të madhe tematike-motivore, në mënyrë të natyrshme krijuan një numër të madh të personazheve si bartëse të veprimeve e të marrëdhënieve të nduarnduarta të një bote trimash, që në një periudhë të caktuar historike, i lanë nam vetes dhe u bënë të denjë t'i kujtojnë tradita prej brezi në brez e deri në ditët tona.

Ndër personazhet interesante të këtyre dy epikave me përkime syzshesh, një vend të posaçëm zë fytyra e Arnaut Osmanit, jo vetëm me elementet e pikëpjekjeve, por edhe me ato dalluese, me veprimet aktive në përmasa të ndryshme në njërën ose në tjetrën sosh, me lartësinë e shkallës që iu dha në hierarkinë e përgjithshme të qerthullit të kreshnikëve, qoftë edhe atë negativ përkitazi me ngjarjet me të cilat qe i ndërlidhur mirë.

Arnaut Osmani në heroikën popullore shqiptare u pasqyrua në një polieder të gjerë profilesh, saqë kur zbulohen dhe vështrohen të gjitha ato, na del si nga personalitetet më komplekse dhe, ndoshta më interesante në radhën e kreshnikëve, pasi vërtet tradita shqiptare e vërejtji atë nga kënde më të nduarnduarta, duke e parë që nga fëmija jetim, i rrëmbyer herë nga Gjeto Basho Muja e herë nga Krajli i Zarës e deri në shkallën e heroit të arsenalit të shenjtoreve në shtratin e elementit mitik e përrallor, gjë që si të këtillë nuk e vërejmë në eposin heroik mysliman bosanohercegovinas, por përkundrazi në korniza më të kufizuara e më të zbehura.

Është interesant të vëmë re se sado që në epikën heroike myslimane bosanohercegovinase rapsodi boshnjak që në fillim të një numri të mirë këngësh, më parë na informon me fytyrat që do të zhvillojnë ndonjë ngjarje gjegjëse dhe ato i radhit zakonisht sipas rolit e pozitës së tyre shoqërore. Kështu që në këtë hierarki fytyrash, ajo e Arnaut Osmanit zë vend rëndom ndër të parat, çka do të thotë në kreun e radhës,<sup>1</sup> e ndonjëherë madje fare në fillim:

<sup>1</sup> Sait Orahovac: *Stare narodne pjesme muslimana BiH*, Svjetlost, Sarajevo, 1976, kënga: *Ropstvo Lalić Jusuf Bega*, f. 140.

*Prvo bješe od Orašca Tale,  
drugo bješe sa Kladuše Mujo,  
i treći je Arnaut Osmane.*

(Mujo Hrnjica pogubi Šimuna  
Brehulju, v. 5—7)<sup>2</sup>

*(I pari ishte Tali i Orashit,  
i dyti ishte Muja i Klladushës,  
kurse i tretë Arnaut Osmani).*

Por, marrë në përgjithësi, e në krahasim me krajishnikët e tjerë, sipas kësaj tradite, nuk mund të vërehet që Arnauti të ketë bërë ndonjë vepër aq të madhe, me ndonjë përjashtim të rrallë, që të jetë dalluar prej të tjerëve, në mënyrë që t'i këndohet ndonjë rapsodi kushtuar kryekrejt vetëm famës së tij, siç ngjet, bie fjala, me Mustaj Beg Liçkin, kryekreshnikun e kësaj epike, Bylykbashe Mujën, Sokole Halilin, Budaline Talin e ndonjë tjetër, nën hijen e të cilëve do të ngelë gati gjithherë Arnaut Osmani.

Po kështu, na duket interesant ta kujtojmë një konstatim me vlerë, që para gati njëqind vjetësh e kishte ngritur Kosta Hörmani përkitazi me këtë fytyrë në epikën heroike boshnjake, respektivisht për kënaqësinë që ndjenin dëgjuesit kur u përmendeshin heronjtë e rrallë të së kaluarës, ndër të cilët një vend nderi zinte edhe Arnaut Osmani: „Në sytë e bejlerëve dhe të agajve tanë vëreja një kënaqësi të posaçme kur këngëtari ua këndonte të kaluarën e lavdishme dhe trimat e njohur; kur përmendte kalorësin Mustaj Beg Liçkin, trimin Bylykbashe Mujën dhe të vëllanë e tij Halilin, Arnaut Osmanin, Begun Lubojeviq dhe bajraktarët shtatëdhur Orllanoviqin, Gjyliqin, Vrshiqin e të tjerë”.<sup>3</sup>

Hörmani në dy vëllimet e këngëve krajishnike myslimane të publikuara nga Bosnja dhe Hercegovina botoi vetëm dy motërzime që parafytyrojnë më drejtpërdrejt fytyrën e Arnaut Osmanit dhe, madje që të dyjat në planin e xhelozisë së shfrenuar të Arnautit kundrejt vëllezërve Hrnjica, Mujës dhe Halilit. Kështu, fjala vjen, në të parën *Muja Hrnjica pogubi Šimuna Brehulju*,<sup>4</sup> anipse Arnauti na del si djalë motre i Mujës dhe i Halilit, do të thotë nip i tyre, për shkak të xhelozisë, provokon ndarjen e çetës prej 300 krajishnikësh në tresh, prej të cilave, të parës do t'i prijë Bylykbashe Muja, të dytës Budaline Tali, kurse të tretës Arnaut Osmani, i cili, ndonëse e konsideronte veten më trim se dajët, në aventurën e tij, do t'ia rrëmbejë motrën Banit të Timokut, por do t'i lërë të vdekur e të plagosur të gjithë bashkëlufëtaret dhe vetë do të plagoset rëndë,

<sup>2</sup> Kosta Hörman, *Narodne pjesme muslimana BiH II*, priredila Đenana Buturović, Svjetlost, Sarajevo, 1976, f. 79.

<sup>3</sup> Kosta Hörman, *Narodne pjesme muslimana BiH I*, priredila Đenana Buturović, Svjetlost, Sarajevo, 1976, f. XIV.

<sup>4</sup> Si fus. nr. 2. f. 79.

gjë që Bylykbashe Mujës së sprovuar ndër aventurat dhe duelet më të rënda, nuk mund t'i ndodhnin katastrofa të këtilla.

Motërzimi *Mujo Hrnjica izbavlja svog pobra Arnaut Osmana*,<sup>5</sup> jo vetëm se zgjeron elementin e farefisnisë së vëllezërve Hrnjica me Arnautin, duke ua atribuar kësaj radhe vëllaminë, por edhe faktori i xhelozisë kësaj radhe shpërthen edhe më ashpër e më drejtpërdrejt, sepse sipas mendimit të Arnautit, ky me fakte ishte më trim se Muja e Halili, pasi në të gjitha përleshjet, ky i bënte gajretet më të njohura, kurse vëllezërit Hrnjica, me famën e tyre, ia përvetësonin. Ndaj, sipas kësaj, ndarja e çetës, tash më dysh, ishte e domosdoshme. Dhe, sadoqë, siç vërehet nga vargjet 362—370, Muja vërtet pranon sheshazi se Arnauti ishte kreshniku më i fuqishëm, përsëri do të bjerë në duart e njerëzve të Banit të Zarës, të cilët nuk ia dalin kurrsesi ta përvetësojnë e ta lidhin me pranga. Prandaj, Bylykbashe Muja, i maskuar me rroba barinjsh, tradhton Banin se ai do të mund ta lidhte Arnautin dhe, gjoja duke u kacafytur me të deri te dyert e pallatit, ia dalin të ikin dhe të shpëtojnë nga robëria që u kanosej të dyve.

Nga epika heroike myslimane bosanohercegovinase rezulton se fytyra e Arnaut Osmanit nuk ishte mjaft stabile. Përkundrazi, na del si njeri që vepron sipas një interesi të caktuar, gjithnjë duke u përpjekur t'i vërë në pah kualitetet e veta të larta prej luftëtari të dalluar, që sipas botëkuptimit të tij minimizoheshin nën peshën e autoritetit të vëllazërve Hrnjica. Andaj gjithë ajo xhelozia e hapur që shpiente kah ndarja e çetës dhe kah dobësimi i unitetit të përgjithshëm të qerthullit të krajishnikëve, së cilës Bylykbashe Muja, anipse i vjen keq, nuk i bën ndonjë rezistencë të posaçme, siç do të bënte, fjala vjen, në eposin heroik shqiptar, por ia bën të mundshme Arnautit këtë ndarje, për t'u provuar më vonë me shembuj praktikë, kur xhelozia do ta pësojë, sepse pretendimet e mëdha të kësaj fytyre ngatërrestare dhe mundësitë, relativisht më të kufizuara se të dajës apo të vëllamit Mujë, ishin në disproporcion, gjë që shpiente kah pësimet permanente të veprimeve të tij e të çetës që i printe.

Kur veçoritë luftarake e njerezore të Bylykbashe Mujës e të Sokol Halilit viheshin në peshojë të dyshimit nga krajishnikët e tjerë, po ky Arnaut Osmani shfaqej si mbrojtës legjitim i tyre, duke përdorur madje argumente më të qëlluara e më të forta për të konfirmuar të kundërtën. Kështu, për shembull, Arnauti, që në këtë epikë shpesh quhet bajraktar ose Osman Bajraktari, kundërshton me ngulm Dizdar Osman Agën dhe xhelozinë e tij kundrejt vëllezërve Hrnjica, që në eposin heroik boshnjak është shumë më i kufizuar se në atë shqiptar. Pra, konfirmon botërisht se këta ishin prijësit më të mirë në radhën e krajishnikëve:

<sup>5</sup> *Po aty*, f. 96.

*Progovara Arnaut Osmane:*

„Nemoj tako Dizdar Osman-aga  
njema gnezda bez sivog sokola  
a ni boja bez Mujina soja.”

(Osveta pogubljenog Mujina  
Halila, v. 310—313)<sup>6</sup>

(*Qiti e foli Arnaut Osmani:*  
*Mo'ashtu Dizdar Osman Aga,*  
*s'ka qerthuj pa petrira,*  
*as luftë pa rodin e Mujës).*

Ky instabilitet i Arnaut Osmanit, respektivisht i Osman Bajraktarit, qoftë në rrafshin e karakterit njerëzor, qoftë edhe të luftëtarit dimensionesh të ndryshme, kështu siç është pasqyruar në eposin heroik boshnjak e madje edhe në atë shqiptar, sa mund të jetë parafytyrim real i këtyre dy traditave, kur kemi të bëjmë me njeriun prej gjaku e prej mishi, aq edhe element subjektiv i rapsodëve, të cilët këtë fytyrë e vështruan nga kënde të ndryshme, simpatie apo antipatie. Por, gjithësesi nga personalitetet më markante në të cilat është pikturuar veprimtaria e tij në këto dy kultura.

Kështu, bie fjala, përderisa në një pjesë të mirë këngësh e motërzimesh boshnjake Arnauti është vështruar si njëri nga trimat më të dalluar, madje edhe në rolin e bajraktarit, herë në krye të çetës së ndarë nga Bylykbashe Muja, herë të plagosur rëndë e herë-herë edhe të rrethuar e të ngushtuar në oborret e banave, por edhe të papërvetësuar, por ndonjëherë edhe të burgosur deri më shtatë vjet e të liruar me besë të dhënë, në këngën *Mladi Marjan i Arnaut Osman*,<sup>7</sup> në të cilën na shfaqet si njëri nga krajishnikët më të rrezikshëm dhe më të gatshëm për provokime e për grindje, jo vetëm brendapërbrenda bashkëluftëtarëve, por edhe në raport me kundërshtarët, Marjani i ri do ta vrasë e copëtojë pa gajret, anipse rapsodi këtë likuidim të Arnautit dhe të tridhjetë krajishnikëve, me Panxhën e Jutbinës në krye, nuk do ta motivojë bindshëm e me elementet e nevojshme dramatike, por përkundrazi do ta zgjidhë konfliktin sa çel e mëshel sytë, në stilin e ashtuquajtur deus ex macina, fenomen ky që e vërejmë mjaft shpesh në epikën heroike boshnjake e madje edhe në atë serbokroate në përgjithësi.

Në kuadrin e poezisë epike myslimane boshnjake, sipas mendimit tonë, krijimi më i plotë për Arnaut Osmanin është në këngën *Osman bajraktar i Zadarski ban*<sup>8</sup> në të cilën profili njerëzor i tij

<sup>6</sup> *Narodne pjesme muslimana u Bosni i Hercegovini* — iz rukopisne ostavštine Koste Hörmána, redakcija, uvod i komentar, Đenana Buturović, Sarajevo, 1966, f. 97.

<sup>7</sup> Vuk Stef. Karadžić, *Srpske narodne pjesme* III, Prosveta, Beograd, 1976, f. 153.

<sup>8</sup> Si fus. nr. 6, f. 111.

është dhënë në disa dimensione. Njëherë si rob në burgun e Banit të Zarës më se shtatë vjet e mandej edhe si trim e njeri i besës e i fjalës. Në të vërtetë, në këtë këngë trajtohet motivi i rinjohjes së burrit me gruan ose siç e kanë quajtur në serbokroatishte i burrit në dasmë të gruas, për të konfirmuar kësisoj disa nga kualitetet njerëzore dhe fizike të këtij heroi.

Arnaut Osmanin, siç ngjet në disa motërzime të këtij motivi, për fejesën e gruas me Bajiçiq Aliun, do ta informojë një i burgosur rishtazi, e kësaj radhe uskok Radovani, i cili kishte rënë në të njëjtin burg. Për lirim të Arnautit me kushte, do të ndërhyjë grua-ja e Banit të Zarës, anipse në formë mjaft sipërfaqësore dhe të zbehtë. Bani këtë lirim të përkohshëm do t'ia kushtëzojë Arnautit me dorinë e mejdanit, me motrën Ajkunën, me tridhjetë pushkë të vogla të krajishnikëve, me njëqind desh e njëqind qe të majmë e të tjera. Me përjashtim të motrës, Arnauti do t'i pranojë të gjitha kushtet dhe, mbi të gjitha, lirim do ta fitojë në bazë të besës që do t'i lërë peng Banit:

*Znaš li, bolan, od Zadarja bane,  
prije će se kamen rastopiti,  
nego vjera u dobra junaka.  
Opet ću ti se sa Krajinie doći,  
tebi bane, otkup donjeti.*

(v. 351—355)

*(A e di, more, Bani i Zarës,  
përpara ka me u shkri guri,  
se besën e lidhun m'e thy burri.  
Prej Krahine opet do të vi,  
edhe kushtin un do to bi).*

Këtu do cekur se ky lirim i kushtëzuar i përkohshëm nuk bëhet me ditë të caktuara, siç ngjet, bie fjala, në gojëdhënat shqipe të këtij motivi, por po kështu, rëngjet e ngarkuara Arnautit janë jashtëzakonisht të mëdha e të rënda, e që nuk i vërejmë në shqipet.

Ndryshe, Arnauti do t'i gjejë dasmorët e Bojiçiq Alisë në oborr dhe, si zakonisht, nuk do të njihet nga askush. Prandaj, të gjithë, Mujën, Bojiçiqin, nënën e vet e të tjerët, do t'i mashtrojë se gjoja me duart e veta ka „varrosur” Arnautin, për t'u hequr atyre çdo dyshim se ai gjendet ndër të gjallët. Mirëpo, syzheu do zgjidhjen e vet dhe, natyrisht kjo do të rrjedhë në një vijë mjaft të motivuar, kur Arnauti i futur në mesin e dasmorëve, si i burgosur, do të zhvillojë disa gara me Sokol Halilin, njërin nga dasmorët më trima e më të shkathët, siç janë hudhja e gurapeshit, të kërcyerit së largu dhe të kapërcyerit mbi tre kuaj të rreshtuar pranë e pranë, në sha-

lat e të cilëve ishin vënë edhe nga tri thika të ngritura përpjetë e në të cilat, anipse Halili ishte i sigurt në vetveten, ishte lidhur edhe me koka, Arnauti do t'ia dalë, por nuk do ta çartë:

*„Çuješ mene, od Kladuše Mujo,  
na poklon Halilova glava!  
Ja ne mogu njega posjeći!  
Daleko se Halil jeste čuo,  
za njega čuje sve sedam kraljeva,  
za njegov sultan u Stambolu znade.  
Nek ne reču mladi Krajišnici,  
da je Osman posjekao Halila,  
a Halila, svojega dajidžu!”*

(v. 784—792)

*(„A ngo knena Muja i Klladushës,  
fal të koftë kryet e Halilit,  
unë ato, bre, nuk muj m'e pre!  
Larg Halilit zani i ka shkue,  
shtat krajlia zanin ja kan ni,  
din për to Sulltani i Stambollit.  
Mos të thonë krajishnikt e ri  
se Osmani e preu Halilin,  
preu Halilin dajën e vet”).*

në mënyrë që pas këtij zbulimi, Arnaut Osmani t'i ndalë dasmorët e Bojiçiqit në konak e në darkë dhe të nesërmen, për të mos i lëshuar atë e dasmorët duarthatë, ai ndal gruan, si në shqipet tek Lala Bajrem<sup>9</sup> e gjetiu, por i jep motrën Ajkunën, që ky moment i rëndë psikik e njerëzor të përfundojë si është më së miri. Ndaj, për këtë akt burrërie, krajishnikët, duke filluar nga Muja, do t'ia fallin tridhjetë pushkë të vogla dhe tridhjetë xheferdare, që ia kishte kërkuar Bani i Zarës, kurse 100 desh dhe 100 qe të majmë ia siguroi Mustaj Beg Liçki, po për të njëjtin qëllim.

Në këtë motërzim, Arnaut Osmani, pasi ia dorëzoi Banit të Zarës të gjitha rëngjet e kërkuara, për të cilat ishte obliguar dhe, madje kishte lënë edhe besën peng, ikën me kalin e tij të shpejtë në Krahinë, duke ai rrëmbyer Banit edhe të birin, nëpërmjet të cilit do t'ia dalë në krye ta lirojë uskok Radovanin dhe t'ia marrë të bijën Angjushën, po për Radovanin, i cili ishte edhe vëllam i Arnautit dhe i disa krajishnikëve të tjerë.

Kështu, pra, rapsodi boshnjak, këtij motivi me elemente të përbashkëta edhe me legjendat popullore shqiptare i dha një zgjidhje të vetën duke e kontaminuar lirimën e kryeheroit, jo vetëm

<sup>9</sup> Demush Shala, *Këngë popullore legjendare*, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore të KSA të Kosovës, Prishtinë, 1972, f. 116.

me çështjen e besës si virtyt të çmuar lart nga patroni i burgut, por edhe me tradhtinë pas kryerjes së të gjitha obligimeve sipas fjalës së dhënë e pastaj, në vijë të dyfishtë, të liruarit edhe të burgosurit tjetër, po kështu të kushtëzuar, ndërsa në shqipet të burgosurit e tjerë lirohen për hir se kryeprotagonisti Aga Ymeri, Ali Bajraktari e ndonjë tjetër, për besë të dhënë, kthehen në burgje dhe se kjo vlerësohet si akt burrërie të rrallë, që natyrshëm imponon edhe lirimin human.

Vlerësuar çështjen sipas të dhënave që na japin vetë këngët e këtyre dy epikave, rezulton se në eposin heroik shqiptar kjo fytyrë ka zënë më shumë vend se në atë mysliman dhe se është trajtuar në një llojshmëri më të madhe, duke nisur që nga prejardhja sociale e deri në shkallën e heroit popullor me cilësi personazhesh mitike e përrallore.

Në disa motërzime fjala vjen Arnaut Osmanin e vërejmë si fëmijë të një gruaje të ve nga Zara, së cilës Gjeto Basho Muja ia paska prishur pasurinë dhe ia paska rrëmbyer njërin djalë, herë Arnautin e herë-herë të vëllanë e tij Siran Tin Aliun. Pra, kemi të bëjmë këtu me motivin e vëllavrasjes dhe të rinjohjes së vëllait me të vëllanë, siç është rasti i Hyso Radoicës, i cili në mesin e tridhjetë kapidanëve të krajlisë, pasi prozhmohet pse nuk po martohet, deklaroi prerë: „*Ndo i marr nusen Arnaut Osmanit, / ndo n'Jutbinë kryet due me lanë*”.<sup>10</sup> Që kështu martesë me rrëmbim, madje me gruan e të vëllait të panjohur, t'i japë shkas kësaj rinjohjeje, të duelit shumë të rreptë, të cilin do ta zhvillojnë vëllezërit me fuqi të njëjta, por që më në fund të bisedojnë hapur dhe të zbulohen:

*E kysmet prej zotit kenka kenë,  
na sot vlla me u bashkue.  
T' dyve lott u paskan pshtue,  
shoqishojnë ngrykë e kanë marrë.* (v. 326—329)

për të pasuar në këtë rrjedhë të kërkuarit e s'ëmës, gjetjes së saj, gëzimit të pakufishëm të nënës dhe të vdekjes së atypëratyshme nga ai moment lumturie të papritur dhe të padureshëm për zemrën e moshuar e të vuajtur për djemtë e humbur e mallin e bjerrë.

Prej këtij motërzimi, rezulton, madje, se Gjeto Basho Muja e rrëmbeu Arnautin në Zarë pasi lakmoi bukurinë e tij fëmijërore, e pagëzoi me këtë emër e mbiemër, ia siguroi jetën e rritën dhe e martoi me nusen, ndër më të bukurat, për t'u bërë ajo objekt lakmie trimash dhe për t'i dhënë shkas aventurës së Hyso Radoicës dhe rinjohjes së tij me të vëllanë Arnaut Osmain.

*Hyso Radoica e Arnaut Osmani*,<sup>11</sup> motërzim i shënuar në ditët tona në Muzheçek — Triesh të Malit të Zi, ndërkaq është gati krejt

<sup>10</sup> Instituti i Foklorit, *Foklor shqiptar II — Epika legjendare* (Cikli i kreshnikëve), vëll. I, Tiranë, 1966, f. 133.

<sup>11</sup> Gjergj Hasanaj, *Malësori këndon* (këngë popullore nga shqiptarët në RS të Malit të Zi), Cetinë, 1971, f. 189.

e njëjtë me të parin, madje diçka më e shkurtër, më i rudhur e më i dobësuar, kurse *Siran Tin Alija dhe Arnaut Osmani*,<sup>12</sup> anipse ka plot pikëpjekje me dy motërzimet e sipërme, përsëri na sjell ca risi e plotësime me interes. Kështu, për shembull, nusja e Arnautit, tash e rrëmbyer nga Siran Tini, kur sheh vëllezërit e panjohur, të lodhur me shpirt nga dueli shumë i ashpër, u lutet trimave:

*Nusja rrite n'kamë tuj shikjua.  
„Pash ni zot, djelmoça, qi ju ka dhanë,  
ndalnju pak sytë ç'i me i la!”* (v. 108—110)

që ky pushim të bëhet shkas i një bisede të shtruar deri në rinjohje. Në këtë motërzim Arnaut Osmani na del banor i një krajlie të pidentifikuar, kurse Siran Tin Alija ndodhej në qerthullin e kreshnikëve, ndërsa pas rinjohjes që të dy do të kthehen përsëri në Krajli e jo në Jutbinë. Këtu vërejmë një fenomen interesant që ka të bëjë me çështjen e moshës. Vërtet, në të gjitha variantet Arnauti na shfaqet si vëllai më i madh, andaj edhe rikthimi, pas ribashkimit të vëllezërve, bëhet prore në selinë e tij, kudo qoftë ajo. Prej kësaj edhe rezulton se ky edhe ishte kryehero me elemente të theksuara gojëdhënore. Si të këtillë Arnaut Osmanin nuk e kemi hasur në epikën heroike myslimane bosanohercegovinase.

Këtë fytyrë në planin e xhelozisë, anipse ndoshta jo në ato përmasa si në epikën boshnjake, e hasim shpesh edhe në epikën heroike shqiptare e me një llojshmëri të nduarnduart. Ta zëmë në këngën *Omeri prej Mujit*<sup>13</sup> Arnauti xheloz kundrejt vëllezërve Gjeto Basho Muja dhe Sokol Halili, kur vëren Omerin shtatëvjeçar, që po vinte në kuvendin e kreshnikëve, jo vetëm se fton kuvendin mos t'ia bëjë trimit të ri respektin e duhur, por edhe nuk mund të durojë lavdin e tij se gjoja do t'i dalë në duel bajlozit të detit, gjë që nuk guxonin ta bënin kreshnikët e tjerë, prandaj ia komunikon lajmin e hidhur:

*— Ti me kenë, Omer, qysh po thue,  
babë e mixh në burg qi i ke,  
ti prej burgut i kishe xjerrë.  
Qe shtatë vjet krajli t'i ka xanë,  
e n'Kotorr kryet po ta lanë.* (v. 133—137)

për t'ia thyer kështu ndjenjën e krenarisë djalošare dhe për ta futur në ndërmarrjet më të rënda, ja s'mund t'ia humbë kokën si djalë të Gjeto Basho Mujës, xhelozinë kundër të cilit do ta shfryejë radhë pas radhe edhe në *Deka e Halilit*,<sup>14</sup> që siç thotë këngëta-ri popullor: *Inatçuer Mujin e ki pasë* (v. 45) për t'u përpjekur si e si ta futë kryekreshnikun në aventura sa më të rrezikshme, kur

<sup>12</sup> Instituti i Shkencave, *Këngë popullore legjendare*, Tiranë, 1955, f. 65.

<sup>13</sup> IF, FSH II, e cit. f. 229.

<sup>14</sup> *Po aty*, f. 250.

mundte ai e kur nuk mundte, duke synuar t'ia humbë kokën sa më parë e të lirohet sish, sikur ia kishte zënë rrugën. Xhelozia e Arnautit e shoqëruar gjithnjë me provokime do të shpërthejë edhe më fuqishëm në rapsodinë *Muji i varruem*,<sup>15</sup> në të cilën janë vënë në spikamë disa momente në raportin e marrëdhënieve të këtyre dy kreshnikëve, kur, për shembull, Arnauti nxit Gjeto Basho Mujën të ndërmarrë aksione edhe në ditët e kushtëzuara, madje edhe atëherë kur për rrezikun që i kanosej i jepte shenjë gjogu duke lo-tuar e duke çukurmuar tokën me këmbë, por: *Atherë foli Arnaut Osmani: / — Tuj u plakë, tha, Mujo, e tuj u tutë / se gjogu i yt kurr-gja nuk din.* (v. 9—11), për ta futur në duele me kundërshtarët, të cilët do ta plagosin rëndë kryekreshnikun e që, në këtë rrjedhë, të pasojë një skenë interesante, nëpërmjet së cilës do të vërejmë se këta të dy ishin në një farefisni mjaft të afërt. Pra:

*Atherë foli Gjeto Basho Muja:  
— A merr vesht, Arnaut Osmani?  
ma i pari shoq ti m'ke qillue,  
amanet ty po ta la,  
armë e petka n'shpi me m'i çue,  
me ma çue gjogun e mejdanit.* (v. 20—25)

të cilat, pason nga vargjet, Muja do të dëshironte t'ia linte trashëgim djalit, që ende nuk i kishte lindur. Megjithatë, përgjigja e Arnautit në këtë moment të rëndë shpirtëror të kryeheroit të plagosur për vdekje, ishte tepër arrogante, por gjithësesi edhe reflektim i drejt-përdrejt i atyre marrëdhënieve të acaruara pavarësisht nga farefisnia, sepse si do të mund të shpjegohej ndryshe, kur Arnauti në vend që t'i ofrojë kushëririt butësi, i dëshiron t'i lindë vajzë, që sipas botëkuptimit popullor, do të thotë mos të trashëgohet, që ky t'ia gëzojë armë e rroba, ta shilojë gjogun e tij dhe t'ia marrë gruan, për ta ganduara sa më rëndë në momentin e vdekjes.

Mirëpo, rapsodi nuk do ta përfundojë ngjarjen kështu. Përkundazi, si në përralla edhe këtu do të fitojë e mira dhe e drejta njerëzore. Andaj kryekreshnikun, të thuash do ta ringjallin zanat me bërat e tyre, do ta shërojnë dhe do ta kthejnë në shtëpi, ndër shokë, për të pasuar ajo më e rënda për Arnaut Osmanin:

*Fort me te Muja a ngushtue.  
Halla, n'kambë Muji kenka çue,  
tha, shpatë në qafë Muji te i ka ra,  
tha, kryet në tokë Muji ja ka qitë:  
— Fjalët e këqija në ditë t'dekës m'i ke pa'thanë!*  
(v. 76—80)

<sup>15</sup> Po aty, f. 253.

Po kështu, në rapsodinë *Gjogu i Mujit*<sup>16</sup> Arnaut Osmani do të lozë edhe një lojë të pahijshme kundrejt Gjeto Basho Mujës, kur duke lakmuar dhuratën e madhe në para, që jepte Krajle Kapidani i pamentifikuar, për atë që do t'ia dilte në krye t'i rrëmbente kryekreshnikut gjogun, inscenon marrjen e flokëve të djalit, duke zënë kumbar pikërisht kryeherin e eposit tonë heroik, që në momentin e ceremonialit, kur të priten flokët, Arnauti të qeshë me të madhe, e Krajle Kapidani të futet tinëzisht në ahër dhe t'ia vjedhë gjogun. Kjo, natyrisht realizohet për t'u pasquruar Arnauti edhe kësaj rradhe në rolin e tradhtarit më përfid. Pra, gjithsesi si fytyrë negative, madje nga ato më të dalluarat në këtë sferë në qerthullin e kreshnikëve shqiptarë, ndonëse Gjeto Basho Muja, në saje të kualiteteve të larta njerëzore, do të përpiqet ta shporrë këso rruge, e ndonjëherë edhe të angazhohet pa rezervë, së bashku me të vëllanë Halilin e kreshnikët e tjerë, ta nxjerrë nga burgjet e krajlave ku kishte kaluar më se shtatë vjet.

Shih në këtë plan ndan në shenjë raspodia *Arnaut Osmani*<sup>17</sup> nga e cila mësojmë se Arnautin me të motrën Mejremen: *Bukuri n'to veç zoti qi ki falë* (v. 103) i kishte burgosur Krajli i Kotorrit dhe i kishte dhunuar në mënyrat më të tmerrshme, duke ua fyer edhe dinjitetin njerëzor me gjithfarë masash, e për të cilin Muja do t'i thotë Halilit, kur me dylbi do të vërejnë një skenë tepër të ulët se:

— *Atij i thonë, ore, Arnaut Osmani,  
dymdhetë vjet jesir qi e kanë n'xanë,  
ma azgan besa turkija nuk ban.* (v. 252—254)

Dhe, më tutje, pason nga vargjet, Sokol Halili, do të futet i maskuar në oborrin e Krajlit pikërisht në ditën kur ai martonte të motrën, kur Mejremja shërbente dhe keqtrajtohej nga dasmorët e dehur e të porositur për gjeste të mbrapshta, kurse Arnauti i lidhur këmbësh e duarsh, shikonte i mllëfosur dhe dëneste në pamundësi për farë ndërmarjeje. Kjo gjendje, natyrisht, do të ndryshojë, si në përralla dhe pasi Sokol Halili ia heq prangat Arnautit e kreshnikët e tjerë sulmojnë nga jashtë. Atëherë ish i burgosuri do ta presë vetë krajlin duke i deklaruar më parë me plot krenari: — *A ke ditë, bre, qi kam kan n'dyja? / O bash mixhë Mujën, ore, unë e kam.* (v. 341—342) etj.

Nga kjo rezulton se Gjeto Basho Muja pranon botërisht se Arnaut Osmani është trim mbi trima, por në anën tjetër edhe Arnauti konfirmon farefisninë me kryekreshnikët, pavarësisht nga xhelozia kaq e theksuar në një pjesë të mirë këso krijimesh.

<sup>16</sup> *Po aty*, f. 109.

<sup>17</sup> Dorëshkrim në arkivin tim. E këndoi Halim Kadrijaj (Budakovë-Suharekë), e shënoi Milazim Kadrijaj student i SHP të Prishtinës.

Radosav Medenica, ndërkaq, duke krahasuar këngën shqiptare *Arnaut Osmani*<sup>18</sup> me ato të epikës heroike myslimane bosanohercegovinase, të cilën të përkthyer në serbokroatishte ia kishte ofruar Dragutin Miqoviqi, nuk gjeti ndonjë analogji, por tha: „Kënga e Arnaut Osmanit ka ngjashmëri me këngën serbe *Mali Radoica* të Vukut III, k. 51”.<sup>19</sup> gjë që është e vërtetë se njëmend këto dy vlera trajtojnë një syzhe që ka të bëjë me heroin që shtiret si i vdekur në burg, mbi trupin e të cilit bëhen prova të tmerrshme për t'ia zbuluar kopilinë, e që pavarësisht nga stërmundimet, nuk jepet.

Në këtë plan do cekur, po kështu, se në këtë syzhe të njëjtë, rrjedhat e zgjidhjes së konflikteve edhe përkojnë herë-herë, por edhe ndryshojnë shpesh. Në shqipet, madje në këtë syzhe u krijuan disa motërzime me interes, sepse si të tilla profilizojnë në kënde më të ndryshme fytyrën e Arnautit, gjë që nuk e hasim edhe në serbokroatishtet.

Kështu, për shembull, Arnauti në shqipet ka një vetëbesim të jashtëzakonshëm se nuk ka prova të cilave do të u nënshtrohej e të tradhetojë idealin e vet për t'u liruar nga prangat e burgut: — *N'shtatë furra t'kuquna me m'shti / qerpiku i synit nji herë s'ka me m'u dridhë.* (v. 53—54), kurse Mali Radoicës i mungon kjo skenë. Arnauti kishte rënë në burgun e një krajli të paidentifikuar së bashku me dymbëdhjetë shokë dhe se mbajtja e burgut me këmbë të lidhura më se gjashtë vjet iu kishte mërëzitur tepër, kurse Radoica bie në duart e Beqir Agës së Zarës, në burgun e të cilit do të qëndrojë vetëm një natë. Aty do të gjejë edhe njëzet shokë të burgosur, që kishin pritur t'i lirojë ai, e kur e shohin edhe atë në burg, qajnë e mjerojnë, në mënyrë që trimi t'i qetësojë, duke u premtuar se do të shtiret si i vdekur, e kur Beqir Aga ta varrosë, do të dalë nga varri dhe do t'i lirojë, siç edhe vepron.

Aktin e shtirjes e kemi edhe tek Arnauti si edhe klithjen e të burgosurve e kërkesën e tyre që gjoja t'u hiqen të vdekurit andej, se pse gjoja janë qelbur dhe u vjen erë e keqe. Në shqipet, krajli pasi bisedon për hallet e të burgosurve, dërgon vajzën të vërtetë „vdekjen” e Arnautit. Pasi ajo ishte dashuruar në të, përfill këtë lojë dhe, në të gjitha ndërmarrjet është në anën e heroit, ndërsa te Mali Radoica, Beqir Aga e ha kopilinë e „vdekjes” dhe do ta varrosë atë, sikur mos të ndërhynte e shoqja Beqir-aginica, me insistimin e së cilës do të bëhen një sërë provash, që herë përkojnë e herë-herë ndryshojnë në këto dy krijime në paralele.

Kështu, fjala vjen, Mali Radoicës, me kërkesën e Beqir-aginices, do t'i ndizet zjarr në gjoks, në gji do t'i lëshohet një gjarpër shullani, nën thonj do t'i futen njëzet kunjë, kurse Arnaut Osmanit, vetë krajli do t'ia lëshojë në gjoks nëntë gjarpinj shullani, që do ta qokasin, do ta fusë në mes të dy zjarmijeve përderisa t'i pëlcase

<sup>18</sup> IF, FSH II, e cit. f. 161.

<sup>19</sup> Radosav Medenica, *Arbanaške krešničke pesme i naša narodna epika*, Rad IV Kongresa saveza folklorista Jugoslavije, u Prizrenu 1967, Beograd 1974, f. 232.

lëkura para e prapa dhe do t'ia fusë nën thonj njëzet majë gozhdash për t'i pëlçitur gjaku anëpërtej.

Dhe, anipse këto sprova të ngjashme, kund diç më të lehta e kund më të rënda, siç do të thoshte rapsodi shqiptar, këta heronj: „Gjallë ishin kanë, por për t'gjallë s'ishin ndi”, prova e fundit me vajza, tek Radoica: „*Sakupite kolo devojaka, / I pred njima lijepu Ajkunu, / Hoće li se nasmejati na nju*” (v. 75—77)<sup>20</sup> (Le t'vallëzojnë rreth tij vajzat, / le t'u prijë Ajkuna e bukur, / ndoshta asaj do t'i qeshet.), kurse tek Arnauti, krajli: *M'i ka zgjedhë tridhetë çika t'mira... / për rreth t'deknit po kcejnë...* (v. 132 dhe 135), sikur ishte më e rrezikshmja për të dy këta, sepse kur vërejnë pranë në valle vajzat e bukura, Ajkunën e Beqir Agës dhe Çikën e Krajlit u shkon buza në gaz, por Ajkuna ia mbulon fytyrën Radoicës, ndërsa Çika e Krajlit, kundërshton shoqet që duan ta zbulojnë këtë mësheftësi duke i mallkuar: — *Zoti u vrastë, çika, u ka thanë, / se ky djalë, i herë ka dekë, / krejt gjynahet ja ka falë, / shpirti n'gaz, shoqe, i ka dalë.* (v. 148—151) Kjo do të thotë, madje se kjo tablo edhe është pika më e dobët e këtyre dy të rinjve trima, por edhe sikur është përdorur me qëllim të caktuar për të vënë në pah edhe rolin e madh të botës femërore në këtë rrjedhë të konfliktit, ndonëse në Mali Radoica Ajkuna sikur është diçka më e kufizuar në misionin e saj, kursa Çika e Krajlit gjithnjë shumë e angazhuar për ta shpëtuar Arnautin në aventurën e rrezikshme. Ndryshe, në Mali Radoica shoqes së Beqir Agës i është dhënë më shumë vend si fytyrë negative sesa së bijës Ajkunës si pozitive.

Në rrjedhën e mëtejme, ngjarjet në këto dy këngë do të zhvillohen ndryshe. Fjala vjen, tek Mali Radoica, pas sprovave të theksuara, prapë me kërkesën e Beqir-aginicës, trupi i Radoicës do të hidhet në det „që të ushqehen peshqit me mishin e hajdutit”, por heroi, notues i mirë do të dalë në një kodër, do t'i nxjerrë kunjat me dhëmbë, do të kthehet në mbrëmje në shtëpinë e Beqir Agës, do t'ia presë atij kokën, ndërsa Beqir-aginicës do t'ia fusë të njëzet kunjat nën thonj që ta provojë edhe ajo tmerrin përderisa ta lëshojë shpirti dhe, me ndihmën e Ajkunës do t'ia lirojë të njëzet shokët e burgosur, do t'ua ndajë gjithë arin e Beqir Agës, kurse vetë do ta marrë Ajkunën për grua e do ta pagëzojë me Angjeli.

Me sugjerimin e së bijës, krajli, në prezencën e një bajlozi të njohur, do t'ia heqë Arnautit bylegitë nga këmbët dhe prangat nga duart dhe, për ironi do t'ia vërë shpatën mbi kokë si gjoja njeriut të vdekur, por kur trimi heton t'atun e shpatës: *Fluturim në kambë asht çue, / shpatën n'dorë ai po ma merr.* (v. 170—171), që me shpejtësinë më të madhe ta presë bajlozin dhe shumë të tjerë, ta verbojë krajlin, t'ia presë njërin krah, t'ia bëjë kullat hi e pluhur, t'ia shpëtojë të dymbëdhjetë shokët dhe t'ia rrëmbejë të tridhjetë vajzat, të cilat kishin vallëzuar rreth tij për t'ia martuar me to tridhjetë kreshnikë e vetë me vajzën e krajlit.

<sup>20</sup> V. S. Karadžić, *vep. e cit.* f. 255.

Prej kësaj edhe rezulton se në syzheun e përbashkët rapsodi shqiptar dhe ai serb futën plot elemente origjinale, qoftë në hyrjen e konfliktit, qoftë në përfundimin e tij, duke e trajtuar atë edhe në përmasa të ndryshme edhe në aspektin dramatik, që në shqipet duket shumë më i fuqishëm, më i shtruar, më i motivuar, jo vetëm pse rapsodia shqiptare ka kund nja tridhjetë vargje më tepër se ajo serbe, por edhe pse është më e kursyer nga ca përsëritje nga të cilat vuan kënga e Mali Radoicës, posaçërisht kur kemi të bëjmë me kokëfortësinë dhe me kërkesat e Beqir-aginicës për t'u vazhduar provat mbi trupin e Radoicës si sakrificë.

Tradita popullore shqipe në këtë syzhe, krijoi një sërë motërzimesh, nga të cilat, anipse me analogji, burojnë momente që plotësojnë mirë profilin e këtij heroi simpatik. Kështu, për shembull, kënga *Arnaut Osmani*,<sup>21</sup> na thotë se Arnauti kishte rënë në burgun e një krajli, prapë të pidentifikuar, me tridhjetë kreshnikë dhe se me iniciativën e vet, duke provuar lirim, kishte pirë njëfarë bari të vdekjes, por kësaj radhe krajli do të bëjë prova mbi trupin e tij sipas këshillave të nënës ugruzezë, e cila do t'i mësojë që të „vdekurit” t'i qesin një kaci prush mbi zemër, t'ia lëshojnë në gji tre gjarpinj shullani dhe në fund të vallëzojnë rreth „kufomës” tridhjetë vajza të bukura.

Mirëpo, Rrushja, vajza e Krajlit, e cila na duket më e angazhuara kësaj radhe, nën prush kishte vënë tri pëllëmbë hi, gjarpinjve ua kishte hequr dhëmbët, ndërsa kur Arnautit i shkon mustaku në gaz nën praninë e Rrushës së bukur vallëzuese, e krajli vetë dyshon se është i gjallë, ajo për t'ia hequr dyshimin, i thotë:

— *Pash 'i zot, babë, si të ka dhanë,  
të lutem ktej per me na hjekë,  
se goja krymba ju ka zatetë,  
se plot goja krymba ju ka mbushë,  
nëpër gojë janë tuj i lujtë,  
aj mustak s'ka si s'i lot!* (v. 105—110)

që më tutje, prapë me iniciativën e saj, krajli t'ia heqë Arnautit prangat nga këmbët e duart, me motivacion se i vdekuri nuk do të duhej të varrosej i lidhur dhe, me lejen e krajlit, Rrushja ta vajtojë këtë trim, për t'i dhënë kështu shenjë se ka ardhur momenti të ngrihet, të bëjë kërdi në njerëzit e krajlit, t'i lirojë shokët dhe të martohet me Rrushën. Megjithatë, ky motërzim, anipse me plot risi, na duket diçka më i dobësuar për nga motivimet e zgjidhjes së konflikteve, e në këtë rrafsh edhe elementet dramatike kanë dalë diçka më të zbehta, sepse përderisa nën prush vihet hiri dhe gjarpinjve u hiqen dhëmbët dhe se kreshnikët qëndrojnë në burg vetëm shtatë muaj, kjo lë përshtypjen e zgjidhjeve më të kurdisura sesa në motërzimin që vështruam më lart. E kjo do të thotë se ky ra-

<sup>21</sup> IF. FSH II, e cit. f. 460.

psod sikur i ka dhënë më shumë vend e peshë Rrushës dhe rolit të saj sesa vetë Arnautit si kryeprotagonist i stoicizmit të tij kaq të njohur.

Po këtë fenomen, por në një formë tjetër, e vërejmë edhe në motërzimin *Arnaut Osmani*,<sup>22</sup> në të cilin Arnautin me dy shokë, Huso Kraboshnikun dhe Kërsto Mustafanë, për t'i munduar si është më së ziut, një krajl i pidentifikuar edhe kësaj radhe, duke u dhënë të hanë mish bollash të cofta e duke i mbajtur në ujë deri në fyt, do të zhvleftësojë çdo dinjitet njerëzor, por edhe i nxit të marrin gjithfarë masash shpëtimi. Këtë barrë, sikurse në motërzimet e tjera, e merr Arnauti, në të cilin na ishte dashuruar vajza e krajlit. Dhe, kur babai dërgon atë të kuptojë revoltën e kreshnikëve, kryeheroi i jep fjalën se do të martohet me të e ajo i deklaron babait: — *U kish dek-e një shoq-e ma i miri. / u ka dek-e, tha Arnaut Osman Aga.* (v. 73—74), që edhe kjo të angazhohet pa rezervë për t'i ndihmuar Arnautit në këtë aventurë të rrezikshme, por edhe ndihma e saj zbut sado kudo efektin e stoicizmit të tij, kur bie fjala, në vend të tre gjarpinjve të shullanit, sipas porosisë së babait, sjell tri bolla të buta, të cilave, duke mos u besuar, ua nxjerr edhe dhëmbët. Në këtë motërzim, madje ka diçka më pak prova. Ato përfundojnë me vallëzimin e dymbëdhjetë vajzave, qeshjen e të cilit, do ta fshehtë prapë Rrushja e krajlit, e cila, po kështu, do të insistojë që i „vdekuri” të varroset pa pranga në duar e në këmbë. Vetë do t'ia ofrojë shpatën me të cilën Arnauti do ta presë krajlën, do të lirohet bashkë me shokët dhe do të martohet me Rrushen.

Ky edhe është motërzimi më i ri, i shënuar në Ftjan të Krajes së Malit të Zi, por edhe ndër më të dobëtit gjë që do të thotë se rapsodi bashkëkohor ka bërë shumë ndërrime në trajtimin e këtij syzheu, sigurisht duke mos besuar në mrekullitë e stoicizmit të një fytyre heroike, pavarësisht nga vështirësit e burgut që edhe e kanë motivuar këtë shtirje, do të thotë këtë vdekje artificiale më përfide, sepse e di rapsodi bashkëkohor se edhe trimat e rrallë janë prej mishit dhe prej gjakut.

Dhe se deri në ç'masë ka evoluar ky motiv në traditën tonë popullore, dëshmon më së miri rapsodia *Çka ka ba ai Arnaut Osmani*<sup>23</sup> në të cilën, jo vetëm se të thuash ka hequr dorë nga sprovat e tmerrshme në trupin e të „vdekurit”, por rapsodi tregon edhe një përkujdesje të veçantë kundrejt kufomës së tij, kur gjoja bën që krajli të respektojë edhe prejardhjen fetare të të burgosurit: *I vorr t'mirë ia ka marue, / tridhetë hoxhë ia ka bashkue.* (v. 84—85) shtresë kjo gjithsesi e re, jo vetëm në këtë syzhe, por marr në përgjithsi në kënetet tona kreshnike, në të cilat thuhet nuk vërehet ceremoniali fetar i varrosjes, sepse kreshnikët vriteshin ndër duele e befeja dhe varroseshin në mënyrën më të thjeshtë, kudo që i zinte puna.

<sup>22</sup> IAP. KK. I, e cit. f. 307.

<sup>23</sup> Nga dorëshkrimi i Ramadan Sokolit në Akrivin e Institutit të Kulturës Popullore të Tiranës.

Megjithatë, në këtë pasuri profilesh, që rapsodi ynë e pa fytyrën e Arnaut Osmanit, është me interes edhe kënga *Arnaut Osmani*<sup>24</sup> që cilësohet me disa elemente të theksuara mitike e përrallore, siç janë, fjala vjen, mendimi i rapsodit për këtë hero: *Ky trim trimit probatin me Mujon, / ka ndej me orët e maleve*. (v. 1—2), që do të thotë, se sipas botëkuptimit popullor, këtij do t'ia kenë dhënë fuqinë këto qenie mitologjike. Si i tillë edhe do t'ia dalë në krye t'i nxjerrë nga burgu i Krajlit të Zarës tridhjetë kreshnikë shqiptarë me Gjeto Basho Mujën në krye, pasi me trimëritë e tij të pareshtura kishte fituar një famë të jashtëzakonshme dhe konsideratë të posaçme edhe në vetëdijen e kundërshtarëve, gjë që na dëshmon bindshëm edhe kjo tablo e thënë pikërisht nga Krajli i Zarës.

*Krajli at gjam-o po e ndi,  
i thotë asqerit: — Shpërndanju në shpij,  
se po vjen Arnaut Osmani  
qi s'e pret pushka as tagani  
as konopi s'e mban për hava  
atij s'ka kush-o shka me i ba.* (v. 15—20)

Në këtë kontekst do theksuar se Arnaut Osmani, i vetmi nga kreshnikët shqiptarë, nëpërmjet kësaj rapsodie mori tipare shenjtërorësh, kur pas lirimt të kreshnikëve, Bylykbashe Mujës, vëllamit të tij, ia dha për grua Gjelinën, të bijën e Krajlit të Zarës dhe vetë u zhduk si hije, sigurisht për të jetuar, si duket i martuar me orët, botëkuptim ky dikur shumë i përhapur në popullin tonë, posaçërisht i rrëfyer edhe në përrallat popullore. Por për ne këtu është me rëndësi të veçantë që ta shohim në një përmasë edhe më të gjerë profilin e kësaj fytyre vërtet të spikatur në kuadrin e heroikës sonë popullore në përgjithësi.

Këtë profil, madje do ta plotësojë edhe më mirë rapsodia *Grueja e Arnaut Osmanit liron agët e Jutbines*,<sup>25</sup> që ndonëse ka për kryehero një femër, e cila bën mrekulli për ta ruajtur pastërtinë morale, përsëri është e lidhur fort me Arnautin, natën e martesës së tij, sepse pikërisht për shkak të famës së madhe që kishte arritur si luftëtar i dalluar, Krajli i Miskovit do ta ftojë në duel, të cilin kreshniku i posamartuar, i motivuar nga krenaria e trimërisë, sikurse edhe të tjerët nga plejada e tij, ndonëse në rrethana të jashtëzakonshme, do ta përfillë, anipse do të zihet rob së bashku me tridhjetë kreshnikët e tjerë, për t'i dhënë shkas kështu gruas së tij t'i afirmojë kualitetet e saj njerëzore dhe aftësitë e posaçme që t'i shpëtojë nga burgu bashkëshortin dhe bashkëluftëtarët e tij. Natyrisht se edhe në këtë krijim interesant vërejmë ndonjë element fantastik e përrallor, siç është, bie fjala, bindshmëria e nuses thënë Arnautit në momentin e ndarjes, kur ia jep këmishën, se përderisa

<sup>24</sup> IF, FSH, II, e cit. f. 382.

<sup>25</sup> IAP, KK, I, e cit. f. 311.

të qëndrojë ajo e pastër dhe e bardhë, le ta dijë se gruaja ia ka ruajtur pastërtinë morale, pavarësisht nga koha e kësaj ndarjeje.

Nga gjithë kjo rezulton se Arnaut Osmani, fytyrë që ndeshet kaq shpesh në epikën heroike shqiptare dhe në atë myslimane bosanohercegovinase herë-herë ka pika kontakti, por në rastet më të shpeshta edhe veçori të posaçme, që nuk i hasim në njërën ose në tjetrën. Kjo, natyrisht pasuron profilin e tij luftarak dhe njerëzor konform me mënyrat specifike të të vërejturit të rapsodëve shqiptarë dhe atyre boshnjakë ndaj marrëdhënieve shoqërore e historike si edhe të vendit që u japin fytyrave si bartëse të ngjarjeve me të cilat janë të ndërlidhura.

Ndërkaq, çështja e prejardhjes etnogjenetike e Arnaut Osmanit ka zënë të zgjojë njëfarë interesimi në ditët tona. Sa dimë ne, në literaturën shqiptare folklorike deri më sot kjo çështje nuk është trajtuar, sepse sikurse edhe kreshnikët e tjerë të rapsodive shqiptare, edhe Arnaut Osmani është përfillur me këtë origjinë. Mbase këtë çështje sikur për herë të parë zu ta shikojë Dragutin Miqoviqi, i cili ndër të tjera thotë: „Sa i përket Arnaut Osmanit, i cili shpesh ndodhet në shoqërinë e turqve të tjerë krajishnikë në këngët e kësaj periudhe, nuk kemi të dhëna të sigurta se kush mund të jetë ky. Mirëpo, edhe fytyra e tij do të mund të shqyrtohej në lidhje me arnavotiqët ose me mbiemrin arnavot (në katundin Snagova e Madhe afër Zvornikut, një numër i madh familjesh mban këtë mbiemër, gjë që origjina e këtij mbiemri do të mund të lidhej)”.<sup>26</sup> E prej kësaj, pra, rezulton se Miqoviqi mendon se Arnaut Osmani do të mund të ketë prejardhje shqiptare edhe në epikën myslimane bosanohercegovinase duke pasur si mbështetje rrethanën e përzierjes së popullatës së këtyre trevave në periudhën e sundimit të gjatë turk, gjë që ndonjëherë në këtë përzierje kanë dalë edhe trima që kanë luftuar bashkarisht e, kjo mund të ketë edhe elemente reale.

Në këtë kontekst ne mendojmë se disa veprime të drejtpërdrejta të Arnaut Osmanit pikërisht në epikën heroike myslimane bosanohercegovinase, madje edhe më shumë se në eposin heroik shqiptar, i japin atij veçori karakteristike të etnosit shqiptar, siç janë, për shembull, të liruarit e tij nga burgu i Banit të Zarës me besë të dhënë, të cilën, siç e kemi vërejtur, nuk e lë peng kurrsesi. Kjo, madje, do të konfirmohet edhe më fuqishëm, kur siç na pohon Kosta Hörmani: „Besa (vjera) edhe nëse i jepet kundërshtarit, është më e fortë se guri. Ja shembulli: Smilaniq Ilia e shpëton nga burgu i zi Arnaut Osmanin, që ta ndajë duelin për të. Osmani, pasi kryen punën, do të kthehet në burg, por Smilaniqi di për zotin, prandaj e ndal si mysafir në konak. I lejon të çetojë, por me kusht që gjahun t'ia sjellë këtij. Kështu, Osmani, pa ditur, rrëmben të motrën e vet dhe, ndonëse i vjen keq, duke respektuar besën, ia

<sup>26</sup> Dragutin Mićović, *O junacima albanske i srpskohrvatske krajišničke epike*, Balcanica VI, Beograd, 1975, f. 310.

sjell Smilaniq Ilisë. Por, nëse Osmani është njeri i besës, as Smilaniqi nuk është i pashpirtë. Kur merr vesh se vajza e rrëmbyer është motra e vëllam Osmanit, ia kthen le t'ia dhurojë të fejuarit të saj. Vërtet, pasqyrë bujare e trimërisë".<sup>27</sup> Ndryshe, një kësi veprimi i Arnautit me kaq sakrificë, jo vetëm se na kujton një analogji të fuqishme të dramës „Besa” të Sami Frashërit, por edhe na konfirmon, ani mirë, prejardhjen etnike të këtij trimi, i cili pavarësisht pse ndodhej në një mes tjetër, trashëgiminë e të parëve, respektimin e besës si virtyt nuk e kishte bjerrë.

*Demush Shala*

LA FIGURE D'ARNAUT OSMANI DANS L'ÉPOPÉE ALBANAISE  
ET MUSULMANE DE BOSNIE-HERZÉGOVINE

R é s u m é

L' épopée héroïque albanaise et musulmane de Bosnie-Herzégovine traite de nombreux thèmes et motifs; elle présente d'une façon naturelle un grand nombre de personnages imaginés se distinguant par leurs multiples actions héroïques dans une période historique définie; les gestes qu'ils ont accomplis les ont rendu immortels dans le souvenir des générations à venir.

Parmi les personnages intéressants de ces deux récits épiques dont les sujets coïncident, la figure d'Arnaut Osmani occupe une place à part, non seulement de part ses éléments à la fois communs et distinctifs, mais aussi par la variété de ses actions et le rôle plus important qu'il joue parmi les preux, rôle tantôt positif tantôt négatif en rapport avec les événements auxquels il est imbriqué.

En observant ce personnage dans les deux chants épiques il résulte que celui de Bosnie, à de rares exceptions près il n'apparaît pas comme se distinguant des autres preux. On le voit plus souvent jouer un rôle d'intrigant animé par la jalousie et des ambitions personnelles. Il manifeste sa jalousie principalement envers ses frères Hrnjica, Bylykbashe Muji et Sokol Halili dont il était le neveu. Il occupe néanmoins un des premiers rangs dans la galerie des personnages du récit.

Dans le récit albanais la figure d'Arnaut Osmani est présentée sous une plus large dimension. Enfant, orphelin enlevé puis homme il se distingue par sa bravoure et un très grand stoïcisme dans les tortures qui ont meurtri son corps. Il apparaît tel un héros fantastique voir un saint, personnage semblable à ceux des mythes et des contes.

<sup>27</sup> K. Hörman, *Narodne pjesme muslimana BiH I*, e cit. f. XVII—XVIII.

The first part of the report deals with the general situation of the country. It is noted that the population has increased during the year, and that the economy is showing signs of recovery. The second part of the report discusses the various departments of the government, and the progress made in each. It is noted that the Ministry of Education has made considerable progress in the field of primary education, and that the Ministry of Health has succeeded in reducing the incidence of certain diseases. The third part of the report deals with the financial situation of the country, and the progress made in the collection of taxes and the expenditure of public funds. It is noted that the government has succeeded in maintaining a balanced budget, and that the public debt has been reduced. The fourth part of the report discusses the progress made in the field of social welfare, and the various measures taken to improve the living conditions of the people. It is noted that the government has succeeded in providing free medical care to the poor, and that the incidence of poverty has been reduced. The fifth part of the report deals with the progress made in the field of agriculture, and the various measures taken to improve the productivity of the land. It is noted that the government has succeeded in increasing the output of certain crops, and that the incidence of famine has been reduced. The sixth part of the report discusses the progress made in the field of industry, and the various measures taken to improve the productivity of the factories. It is noted that the government has succeeded in increasing the output of certain industries, and that the incidence of unemployment has been reduced. The seventh part of the report deals with the progress made in the field of science and technology, and the various measures taken to improve the level of research and development. It is noted that the government has succeeded in funding a number of important research projects, and that the level of scientific achievement has been raised. The eighth part of the report discusses the progress made in the field of culture and education, and the various measures taken to improve the level of cultural and educational activities. It is noted that the government has succeeded in funding a number of important cultural and educational projects, and that the level of cultural and educational achievement has been raised. The ninth part of the report deals with the progress made in the field of international relations, and the various measures taken to improve the country's standing in the world. It is noted that the government has succeeded in establishing friendly relations with a number of important countries, and that the country's standing in the world has been raised. The tenth part of the report discusses the progress made in the field of defense, and the various measures taken to improve the country's military strength. It is noted that the government has succeeded in increasing the size of the armed forces, and that the country's military strength has been raised. The eleventh part of the report deals with the progress made in the field of foreign trade, and the various measures taken to improve the country's trade relations. It is noted that the government has succeeded in increasing the volume of foreign trade, and that the country's trade relations have been improved. The twelfth part of the report discusses the progress made in the field of public administration, and the various measures taken to improve the efficiency of the government. It is noted that the government has succeeded in streamlining its administrative procedures, and that the efficiency of its public administration has been improved. The thirteenth part of the report deals with the progress made in the field of public opinion, and the various measures taken to improve the level of public participation in government. It is noted that the government has succeeded in holding a number of important public hearings, and that the level of public participation in government has been raised. The fourteenth part of the report discusses the progress made in the field of public health, and the various measures taken to improve the level of public health. It is noted that the government has succeeded in funding a number of important public health projects, and that the level of public health has been raised. The fifteenth part of the report deals with the progress made in the field of public safety, and the various measures taken to improve the level of public safety. It is noted that the government has succeeded in funding a number of important public safety projects, and that the level of public safety has been raised. The sixteenth part of the report discusses the progress made in the field of public housing, and the various measures taken to improve the level of public housing. It is noted that the government has succeeded in funding a number of important public housing projects, and that the level of public housing has been raised. The seventeenth part of the report deals with the progress made in the field of public transportation, and the various measures taken to improve the level of public transportation. It is noted that the government has succeeded in funding a number of important public transportation projects, and that the level of public transportation has been raised. The eighteenth part of the report discusses the progress made in the field of public utilities, and the various measures taken to improve the level of public utilities. It is noted that the government has succeeded in funding a number of important public utilities projects, and that the level of public utilities has been raised. The nineteenth part of the report deals with the progress made in the field of public works, and the various measures taken to improve the level of public works. It is noted that the government has succeeded in funding a number of important public works projects, and that the level of public works has been raised. The twentieth part of the report discusses the progress made in the field of public services, and the various measures taken to improve the level of public services. It is noted that the government has succeeded in funding a number of important public services projects, and that the level of public services has been raised.